



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE**

Nr. 34/20 Prot.

Tiranë më, 07.08.2025

V E N D I M

Nr. 07 datë 07.08.2025

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Ornela Dyli	Kryesuese
Loreta Hanxhari	Relatore
Elida Domi	Anëtare

në datën 07.08.2025, në orën 13:15 në ambientet e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT: **Z.Ermal Sali Onuzi** me funksion ish-Drejtor i Përgjithshëm i Gardës së Republikës.

OBJEKTI: **Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Ligji nr. 12/2018** “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoi dhe vlerësoi shpjegimet dhe argumentimin ligjor të Relatorit të çështjes, Znj.Loreta Hanxhari, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në Ligjin 12/2018 të ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Trupa e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore është organi kompetent që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, bazuar në Ligjin nr.12/2018, *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, i ndryshuar.

2. Subjekti i vlerësimit kalimtar, Ermal Sali Onuzi ka dorëzuar *deklaratën e pasurisë, deklaratën e kontrollit të figurës dhe formularin e vlerësimit të aftësive profesionale*, për funksionin Drejtor i Përgjithshëm i Gardës Së Republikës, sipas përcaktimeve të neneve 32 pika 2, 36 pika 1, dhe 44 pika 1, të Ligjit Nr.12/2018, *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, të ndryshuar.

3. Bazuar në Nenin 6 të Ligjit nr.12/2018 *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, i ndryshuar, Z. Ermal Sali Onuzi ka qenë subjekt i vlerësimit kalimtar nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit.

4. Subjekti i vlerësimit, Ermal Onuzi, iu nënshtrua procedurës së shortimit, në shortin e zhvilluar në datën 13.02.2025, nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.07 datë 17.01.2023 *“Për Procedurat dhe Mënyrat e Hedhjes së Shortit për Trupat e Vlerësimit dhe Subjektet e Vlerësimit të Ligjit 12/2018, i ndryshuar”*. Sipas shortit të zhvilluar, Trupa e Vlerësimit përbëhet nga Znj. Denisa Sina (Kryesuese); Znj.Loreta Hanxhari (Relatore) dhe Znj. Elida Domi (Anëtare).

5. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit, sipas nenit 27, pika 1 të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar dhe neneve 30 dhe 31, të Kodit të Procedurave Administrative.

6. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin 12/2018, të ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197 dt.28.02.2023 *“Për hapat proceduralë të unifikuar”*, vendosi me Vendimin

nr.01 datë 04.03.2025 fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Ermal Sali Onuzi si dhe të caktojë Kryesuese të Trupës Vlerësuese Znj. Denisa Sina.

7. Relatori i çështjes, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar të datës 06.03.2025, njoftoi subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar duke i bërë të njohur përbërjen e Trupës së Vlerësimit dhe duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.

8. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, “Deklaratën për Konfliktin e Interesit” me nr. *** prot. datë 17.03.2025, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.

9. Relatori i çështjes në përmbushje të detyrave ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, dhe sipas:

- nenit 7, pika 1 të Rregullores nr. 197 datë 23.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, nenit 4 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 06.03.2025, pranë ILDKPKI-së, formularin e deklarimit të pasurisë për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit .
- nenit 7, pika 7 të Rregullores nr. 197 datë 23.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 06.03.2025, pranë DPPSH-së, formularin e aftësive profesionale për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
- nenit 7, pika 4 të Rregullores nr. 197 datë 23.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 06.03.2025, pranë AMP-së, deklaratën e kontrollit të figurës për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.

10. Garda e Republikës, me shkresë nr. *** prot., datë 16.06.2025, ka informuar Trupën e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në lidhje me Urdhërin nr.74, datë 05.06.2025, të Kryeministrit “*Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës*”, nëpërmjet të cilit Z. Ermal Onuzi, lirohet nga kjo detyrë. Gjithashtu është dorëzuar formulari i Vlerësimit të Aftësive Profesionale me dokumentacionin përkatës.

11. Në vijim Relatori i çështjes ka dërguar njoftimin për lirimin nga detyra për subjektin e vlerësimit Ermal Onuzi, drejtuar ILDKPKI-së me shkresën nr. *** prot., datë 19.06.2025 dhe drejtuar AMP-së me shkresën nr. *** prot., datë 19.06.2025, duke i kërkuar dhe dërgimin e formularëve përkatës të dorëzuar nga subjekti si dhe korespondencën institucionale me dokumentacionin shoqërues të hetimit të deritanishëm.

12. Duke qenë se Kryesuesja e Trupës është me leje lindje, Trupa Vlerësuese me Vendimin nr. *** prot., datë 23.06.2025, caktoi zëvendësimin e Kryesueses Znj.Denisa Sina me Znj.Ornela Dyli për çështjen në fjalë. Znj.Ornela Dyli, sipas hedhjes së shortit të zhvilluar më datë 13.02.2025, është shortuar si anëtare zëvendësuese për Trupën Vlerësuese të përbërë nga Znj.Loreta Hanxhari, Znj.Denisa Sina, Znj.Elida Domi (sipas Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.07, datë 17.01.2023 “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit 12/2018, i ndryshuar”).

II. ARSYETIMI LIGJOR I TRUPËS SË VLERËSIMIT

13. Trupa e Vlerësimit, u njoh me rrethanat e çështjes, administroi edhe dokumentacionin si vijon:

- Urdhërin nr.74, datë 05.06.2025, të Kryeministrit “Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës”

14. Në zbatim të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, sipas nenit 3, pika 18 e tij, “subjekt vlerësimi” janë punonjësit sipas përcaktimeve të bëra në pikat 15,16, e 17 të këtij neni, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 6, të këtij ligji.

15. Duke qenë se, subjekti i vlerësimit **Z.Ermal Sali Onuzi**, është liruar nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës, Trupa Vlerësuese konstaton se Z. Ermal Onuzi nuk është më subjekt vlerësimi sipas Ligjit të Vlerësimit.

16. Në këto kushte, Trupa Vlerësuese deklaron të përfunduar çështjen e hetimit administrativ të nisur ndaj subjektit të vlerësimit, pa një vendim përfundimtar për shkak se interesi, qëllimi dhe objekti për të cilin ka nisur procedura janë bërë ligjërisht të pamundur, duke konstatuar se ndodhet në kushtet e zbatimit të nenit 95 të Kodit të Procedurës Administrative.

PËR KËTO ARSYE

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, mbështetur në Ligjin Nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, si dhe në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;

V E N D O S I:

1. Ndërprerjen e procesit të vlerësimit kalimtar të subjektit të vlerësimit **Ermal Sali Onuzi** me funksion ish-Drejtor i Përgjithshëm i Gardës së Republikës Së Shqipërisë pa një vendim përfundimtar.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet Subjektit të Vlerësimit si edhe Institucionit brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së Vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall sot datë 07.08.2025, në Tiranë.

TRUPA E VLERËSIMIT

Ornela Dyli
Kryesuese

Loreta Hanxhari
Relatore

Elida Domi
Anëtare